



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.23/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit H. B. për shkak të veprës penale krim i organizuar, nga neni 274 paragrafi 1., 2. e 3. të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012, e parashikuar me nenin 283 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodit, nr.04/L-082), mashtrim i rëndë (veprat penale në bashkim dhe veprat penale në vazhdim) në bashkëkryerje nga neni 23, 71 dhe neni 261 par.2 të KPK-së, të parashikuar sipas neneve 31, 81 dhe nenit 335 par.5 të KPRK (Kodit nr.04/L-082), shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe mashtrimit në detyrë (vepra penale në bashkim dhe vepra penale në vazhdim) nga nenet 24, 71, 23 dhe neni 339 par.3 dhe neni 346 të KPK-së, që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor të 2012, të parashikuar sipas neneve 32, 81, 31, 422 dhe nenit 432 par.2 të (Kodit nr.04/L-082), shtytja për kryerjen e veprave penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare ose autorizimit (veprat penale në bashkim dhe veprat penale në vazhdim) në bashkëkryerje nga nenet 24, 71, 23, 339 par.2 dhe 346 të KPK-së, të parashikuar sipas neneve 32, 81, 31, 422 dhe 432 par.2 të (Kodit nr.04/L-082), legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë (vepra penale në bashkim dhe vepra penale në vazhdim) në bashkëkryerje me shkelje të neneve 71 dhe 334 par.2 të KPK-së, të parashikuar sipas neneve 81 e 403 par.2 të (Kodit, nr.04/L-082), pastrimi i parave (veprat penale në bashkim dhe veprat penale në vazhdim) në bashkëkryerje me shkelje të neneve 23 e 71 të KPK-së, të parashikuar sipas neneve 31 e 81 të (Kodit, nr.04/L-082), me shkelje të nenit 10 par.2 të Rregullores së UNMIK-ut, nr.2004/2, mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale të parashikuar edhe sipas nenit 32 të Ligjit nr.03/L-196 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit të 30 shtatorit 2010 dhe sipas nenit 56 par.1 të Ligjit, nr.05/L-096 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, të 15 qershorit 2016, siç është i cekur në nenin 308 të (Kodit, nr.04/L-082), pastrimit të parave (veprat penale në bashkim dhe veprat penale në vazhdim) në bashkëkryerje me shkelje të neneve 23 e 71 të KPK-së, të parashikuar dhe sipas neneve 31 e 81 të Kodit, nr.04/L-082), me shkelje të nenit 32 të Ligjit, nr.03/L-196 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit të 30 shtatorit 2010 e parashikuar edhe sipas nenit 56 par.1 të Ligjit, nr.05/L-096 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit të 15 qershorit 2016, siç është cekur në nenin 308 të (Kodit, nr.04/L-082) dhe veprës penale shmangie nga tatimi nga nenet 71 e 249 par.2 të KPK-së, të parashikuar sipas neneve 81 e 313 par.3 të (Kodit, nr.04/L-082), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit, paraqitur kundër aktvendimit të të Gjykatës Themelore

në Prishtinë - Departamentin Special, PKR.nr.340/23 të datës 06.12.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special PN.1.S.nr.242/2023 të datës 12.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e mbrojtësit të pandehurit H. B. për mbrojtje të ligjshmërisë, ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentin Special, PKR.nr.340/23 të datës 06.12.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special PN.1.S.nr.242/2023 të datës 12.12.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamentin Special, me aktvendimin, PKR.nr.340/23 të datës 06.12.2023, të pandehurit H. B., ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale si në hyrje të këtij aktgjykimi, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi të pandehurit do t'i zgjasë deri më datë 08.02.2023. Të pandehurit masa e paraburgimit i është vazhduar konform dispozitës së nenit 184 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pika 1.2.1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktvendimin PN.1.S.nr.242/2023 të datës 12.12.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit H. B., avokati Agnez Furra, nga P., për shkak të shkeljes së dispozitave të neneve 171, 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pika 1.2.1. dhe nenit 188 paragrafi 2. të KPP-së, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga nenit 432, paragrafi 1. e 4., lidhur me nenin 384, paragrafi 2., pika 2.1. e 2.2 të KPP-së dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale e të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj si të bazuar kërkesën, aktvendimet e kundërshtuar t'i anulon, ashtu që të pandehurin ta liroi nga masa e paraburgimit duke ia caktuar ndonjë masë alternative, masën e arrestit shtëpiak apo masën e dorëzarisë – paluajshmërinë e cila është me vlerë 300.000 € ose shumë prej 10.000 euro.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KMLP.III.nr.16/2024 e datës 10.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit H.B., av. Agnez Furra, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 paragrafi 1., lidhur me nenin 436 paragrafi 1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën e tij pretendon se aktvendimet e atakuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.10 të KPP-së, ngase gjykatat vetëm kanë parafrazuar dispozitat ligjore pa asnjë arsyetim të vetëm, pa arsyetim se për çka saktë po dyshohet i pandehurit. Po ashtu aktvendimet e atakuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse kërkesa për vazhdimin e paraburgimit duhet t'i dorëzohet mbrojtësit dh të pandehurit në afat prej 3 ditësh para skadimit të afatit të paraburgimit, ndërsa të njëjtën nuk e kanë pranuar. Gjithashtu, nuk janë plotësuar kushtet ligjore konform dispozitës së nenit 184 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pika 1.2.1. të KPP-së, ngase gabimisht janë zbatuar këto të fundit sepse nuk është arsyetuar fare, por është marrë fakti se i njëjti ka qenë në SHBA dhe nuk i ka besuar prokurorëve dhe gjyqtarëve të EULEX-it, dhe me të kaluar lënda tek vendoret është ardhur në Kosovë për tu ballafaquar me akuzën dhe për të dëshmuar pafajësinë e tij, i njëjti është i martuar, ka fëmijë dhe është i moshës së shtyrë dhe ka probleme shëndetësore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara, ngase nga provat në të cilat është ngritur aktakuza, e që gjendet në shkresat e lëndës, ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë, ndërsa se a do të argumentohen këto fakte, është çështje që do të vlerësohet dhe vërtetohet gjatë fazave të mëtejshme procedurale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. e 1.2., pika 1.2.1. të KPP-së, për vazhdimin e paraburgimit, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, duke pasur parasysh faktin se i pandehuri ka qenë në arrati për një kohë mjaft të gjatë, afro 8 vite edhe pse ndaj tij ishte lëshuar letër rreshtim vendor dhe ndërkombëtar, i njëjti ka qenë në dijeni për aktakuzën dhe ka prezentuar në seancat fillestare e më pastaj është arratisur, andaj me lënien në liri i njëjti mund të jetë i pakapshëm për organet e ndjekjes dhe në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Sa i përket pretendimit të mbrojtësit se aktvendimet e atakuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 188 të KPP-së, është një pretendim i pabazuar sepse vazhdimi i paraburgimit në këtë çështje penale është bërë nga ana e kryetarit të trupit gjykues sipas detyrës zyrtare konform neni 190, paragrafi 1. të KPP-së.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 171, të KPP-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.23/2024, më datë 12.01.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi